



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**LEGJISLATURA IV**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 126

Prishtinë, më 20.9.2013, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: **Nait Hasani**, Rasim Demiri, **Sevdije Lama**, **Afërdita Berisha-Shaqiri**, Boban Todorović, **Nijazi Idrizi**, Salih Morina.

Mungoi : Liburn Aliu, Daut Haradinaj.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 17.9.2013,
3. Shqyrtimi i projektligjit për fshatin Zymi i Hasit,
4. Të ndryshme.

**Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës, përkundër faktit se ishin prezent 4 anëtarë të komisionit, ngase kryetari konfirmoi se para mbledhjes ka biseduar me anëtarë të komisionit të cilët kanë shprehur pajtimin që komisioni mund të punoi sikur të ketë kuorumin, dhe në mbledhjen e radhës komisioni të vërtetoi punën që është bërë duke votuar për amendamentet që nxjerrën në mbledhjen e sotme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 17.9.2013**

**Kryetari i Komisionit** konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 17.9.2013.

### 3. Shqyrtimi i Projektligjit për fshatin Zyri i Hasit

**Kryetari Nait Hasani** përshëndeti mysafirët dhe komisionin dhe pas rishikimit të punës në mbledhjen e fundit ftoi mysafirët (Hasan Hoti nga Instituti i Prizrenit dhe Vjollca Aliu nga Ministria e Kulturës) të shfaqin mendimin nëse kanë, para se të vazhdoi komisioni me shqyrtimin e projektligjit aty ku ka mbetur në mbledhjen e kaluar.

**Hasan Hoti** nuk kundërshtoi në asnjë aspekt punën e komisionit sa i përket këtij projekti por sqaroi se në Institutin ku ai punon nuk ka pasur asnjë konsultim lidhur me hartimin e këtij ligji, ndaj shprehu drojë mos është e vonë kjo punë, ngase komuna me rastin e miratimit të ligjit merr ca obligime. **Kryetari** shpjegoi se deputeti Haradinaj është propozues i ligjit, ndaj për atë arsye nuk janë kryer punët që i ceku ai. Vazhdoi **z. Hoti** dhe tha se Zyri i Hasit në ditët e sotme është lënë plotësisht anash, sa do të ndihmon ky ligj me u gjallërua ky fshat, mbetet të shihet. Ai shtoi se ende nuk ka rezultate për Ligjin e Prizrenit, ndaj si të shpresohet për Zymin, pyeti mos po hartohen ligje të cilat janë të pazbatueshme.

**Kryetari** ndërhyri rreth çështjes së Prizrenit dhe pasi **z. Hoti** diskutoi rreth pasivitetit të Komunës rreth zbatimit të Ligjit për Prizrenin, autorizoi stafin që ti dërgohet shkresa MMPH me pyetjen pse nuk zbatohet Ligji për Prizrenin, përkatësisht ku gjendet kjo ministri sa i përket këtij Ligji, njëkohësisht kërkoi nga **z. Hoti** jo vetëm aktivitete por ato të përcjellën me shkresa të cilat do të dokumentojnë aktivitetet, sidomos ato të cilat do të duhej ti dërgoheshin Kuvendit të Kosovës si organ mbikëqyrës i zbatimit të ligjeve. Kryetari gjithashtu në vazhdim i ceku edhe disa parregullsi dhe ndërtime ilegale rreth objekteve të monumenteve kulturore siç është ajo e Lidhjes së Prizrenit etj dhe mos reagimin e Komunës bashkë me Institutin. **Z. Hoti** ceku se janë bërë rregullimet hapësinore, por në shumicën e vërejtjeve nuk kishte koment.

**Afërdita Berisha** sugjeroi që zyrtari kompetent nga Instituti të dërgoi listën e shkeljeve të bëra, në mënyrë që të veprohet në mënyrë adekuate nga ky Komision. **Kryetari** përkrahu sugjerimin dhe kërkoi nga Instituti të dërgohet kjo listë në këtë komision.

**Nijazi Idrizi** ndërhyri duke konstatuar se niveli i diskutimit në këtë takim nuk është i duhur, ngase në këtë mbledhje shqyrtohet Projektligji për Zymin ndërsa **z. Hasan** diskuton për largimin e popullatës nga ky fshat, çka nuk duhet të jetë temë diskutimi. Ai kërkoi angazhimin konkret të mysafirëve rreth hartimit të këtij ligji.

**Gjejlane Hoxha** përsëriti vërejtjet nga mbledhja e kaluar për shkak se me ligjet e miratuara janë lënë mjaft zbrazëtira, zonat e veçanta miratohen nga legjislacioni por mbeten pa u shpallë, ndaj edhe Hasi sipas saj duhet së pari të identifikohet me plan hapësinor si hap i domosdoshëm.

Në vazhdim kryetari udhëhoqi procedurën e shqyrtimit të mëtejme të projektligjit dhe pas përfundimit kërkoi nga stafi që amendamentet të renditen për miratim në mbledhjen e radhës.

### 4. Të ndryshme

**Kryetari** në këtë pikë ftoi komisionin për të vendosur lidhur me çështjet si vijon :

1. Në Koroaci do të udhëtojnë komplet komisioni (përveç Boban Todoroviq i cili u deklarua se nuk do të mund të udhëtoji) më 29.9.2013 duke siguruar secili anëtarë i delegacionit dokumentacionin relevant, ngase vizita mbështetet nga MMPH.
2. Në mbledhjen e radhës më 24 shtator të renditet edhe projektligji për ndërtime ilegale, për shkak të përgatitjes së komisionit për vizitën në Kroaci.
3. Stafi i komisionit pas përmirësimit të disa çështjeve teknike në raportin për Inspektorate, të përcjell projektligjin në leximin e dytë.

Mbledhja përfundoi në orën 13,30.

Përgatitur nga:

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

Kryetari i Komisionit,  
**Nait Hasani**

